

## STATUTI

### I SHOQËRISË ME PERGJEGJESI TE KUFIZUARA

#### “BELED” sh.p.k

Tiranë 04.06.2024

Me cilësinë e “ortakëve themelues të shoqërisë “**BELED**“ sh.p.k :

- **Enis Prushi**, atësia Alfred, amësia Mimoza, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues ne Krujë, me adresë Unazë Se Vogel 00860229, Nd.1, H.2, Ap 12, Fushe Krujë, Krujë, lindur me 19.12.1995 dhe mbajtës i leternjoftimit ID nr. 039204018 dhe nr. personal J51219050O, madhor dhe me zotesi të plotë juridike për të vepruar.
- **Leandro Ceku**, atësia Artur, amësia Gentiana, shtetas Shqiptar, lindur në Krujë dhe banues ne Krujë, me adresë Krujë 00860111, Nd.11, H.2, Ap 2, Fushe Kruje, lindur me 28.08.201995 dhe mbajtës i leternjoftimit ID nr. 033221996 dhe nr. personal J50828102Q, madhor dhe me zotesi të plotë juridike për të vepruar.
- **Biori Boka**, atësia Bashkim, amësia Mireda, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë, dhe banues ne Tiranë, me adresë Rr. Ferit Xhajko Nr.87, Njesia Adm. Nr.8, lindur me 10.09.1996 dhe mbajtës i leternjoftimit ID nr. 032779038 dhe nr. personal J60910070D, madhor dhe me zotesi të plotë juridike për të vepruar.

Në cilësinë e ortakëve themelues, me vullnet të lirë, të plotë e të singertë, dhe iniciativën e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, në atë Doganor, Fiskal e Tatimor, kane themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “**BELED**” sh.p.k. (më poshtë e quajtur “Shoqëria”)

#### **KREU I**

Neni I  
Krijimi

Shoqëria “**BELED**” sh.p.k., është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

A handwritten signature consisting of stylized, slanted letters, appearing to read "Neni I".

A handwritten signature consisting of stylized, slanted letters, appearing to read "Biori Boka".

A handwritten signature consisting of stylized, slanted letters, appearing to read "Leandro Ceku".

*Neni 2*  
*Personaliteti juridik*

Shoqëria fiton personalitetin juridik me regjistrimin në QKR.

Shoqëria "BELED" sh.p.k, është një shoqëri tregtare e themeluar nga ortaket e sipershkruar, te cilit nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Kontributi i ortakëve përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaket gjëzojne kuotën e tyre në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që kane dhënë në kapital.

*Neni 3*  
*Selia*

Shoqëria e ka selinë në Rruga "Sabaudin Gabrani", ish SMT me nr pasurie 5/119, ZK.8240 , Tirane. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme.

*Neni 4*  
*Objekti i veprimtarisë*

- Tregti me shumice dhe pakice te materialeve elektrike, materiale ndricimi si led, pllaka ndricuese , tabela ndricuese etj.
- Projektim, Zhvillim dhe instalim i tyre
- Tregti, Import / Eksport
- Tregti import eksport i paneleve diellore.
- Çfarë do lloj aktiviteti tjeter në lidhje me veprimtarinë e sipër përpermendur i lejuar nga Legjislacioni Shqiptar.

*Neni 5*  
*Kohëzgjatja*

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij për një periudhë kohore te papercaktuar.

***KREU II***  
***KAPITALI***

*Neni 6*  
*Kapitali themeltar*

**Kapitali themeltar i shoqërisë është 4.000.000 leke , i ndarë në 3 kuota.**

Kuotat e kapitalit themeltar zotërohen nga ortakët e shoqërisë si më poshtë :

- **Enis Prushi**, atësia Alfred, amësia Mimoza, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues ne Krujë, me adresë Unazes Se Vogel 00860229, Nd.1, H.2, Ap 12, Fushe Krujë, Krujë , lindur me 19.12.1995 dhe mbajtës i leternjoftimit ID nr. 039204018 dhe nr. personal J51219050O, madhor dhe me zotesi të plotë juridike për të vepruar.

**Zotëron 1 kuote (pjese) me pjesëmarje 34 % në kapital ne vleren**

**1.360.000 leke.**

- **Leandro Ceku** , atësia Artur, amësia Gentiana, shtetas Shqiptar, lindur në Krujë dhe banues ne Krujë, me adresë Krujë 00860111, Nd.11, H.2, Ap 2, Fushe Kruje, lindur me 28.08.201995 dhe mbajtës i leternjoftimit ID nr. 033221996 dhe nr. personal J50828102Q, madhor dhe me zotesi të plotë juridike për të vepruar.

**Zotëron 1 kuote (pjese) me pjesëmarje 33 % në kapital ne vleren**

**1.320.000 leke.**

- **Biori Boka** , atësia Bashkim, amësia Mireda, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë, dhe banues ne Tiranë, me adresë Rr.Ferit Xhajko Nr.87, Njesia Adm. Nr.8 , lindur me 10.09.1996 dhe mbajtës i leternjoftimit ID nr. 032779038 dhe nr. personal J60910070D , madhor dhe me zotesi të plotë juridike për të vepruar.

**Zotëron 1 kuote (pjese) me pjesëmarje 33 % në kapital ne vleren**

**1.320.000 leke.**

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregëtueshme.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë;

Neni 7  
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme te Ortakve duke kontribuar në para ose me anë të kontributeve në natyrë, dhe në shërbime, si dhe nga fitimet e shoqërise .

Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 të këtij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale.

Në rast mosbatimi të kërkesave të këtij paragrafi, çdo person i interesuar mund të kérkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur Gjykata mblidhet për të marrë vendim.

*Neni 8*  
*Transferimi i kapitalit*

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

***KREU II***  
***ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE***



*Neni 9*  
*Organë Vendimmarrës*

Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

*Asambleja e Përgjithshme vendos për çështje si :*

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të regjistruar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në Gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë;



Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

d)thirrjen e mbledhjes se Asamblese se Përgjithshme.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 10  
Administrimi

Administrator i shoqërisë është **Z. Enis Prushi**, atësia Alfred, amësia Mimoza, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues ne Krujë, me adresë Unazes Se Vogel 00860229, Nd.1, H.2, Ap 12, Fushe Krujë, Krujë , lindur me 19.12.1995 dhe mbajtës i leternjoftimit ID nr. 039204018 dhe nr. personal J51219050O, madhor dhe me zotesi të plotë juridike për të vepruar

Emëruar në këtë detyrë për një afat 5-vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme

Neni 11  
Kompetencat

*Administratori ka të drejtë e detyrohet të:*

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve i paraqesin këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh)kryejë regjistrimet dhe të dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për

veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme edhe në rastet kur :

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe

kur shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm.

Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve.

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rr Ethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimi i ortakeve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rr Ethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12  
Përgjegjësitet

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Përgjithshme që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesht;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta, kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpérndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Neni 13  
Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqërisë fillon më 1 janar dhe perfundon më 31 dhjetor. Me përjashtim të vitit të parë finanziar që fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllt më 31 dhjetor.

Neni 14  
Bilanci i shoqërisë dhe dividentët

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit finanziar, mbledhja e Asamblesë së Përgjithsme, miraton bilancin e paraqitur nga administratori.

Mbledhja e ortakëve të shoqërisë vendos rreth shpérndarjes së dividentit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm finanziar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15  
Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me

kontrollot periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e Asamblesë së Përgjithshme.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit reportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe për atë për kontrollot periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë Asamblesë së Përgjithshme për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

*Neni 16*  
*Dividenti*

Të ardhurat neto ( Dividenti ) që mbeten pas veçimit të fondevit ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbeten dhe i kalojnë në pronësi, Asamblesë së Shoqërisë, të cilat mund të kalojnë dhe për zmadhimin e kapitalit .

*Neni 17*  
*Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :*

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakut të vetëm;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të Gjykatës;

Në këtë rast Asambleja e Përgjithshme merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “ Shoqëri në likuidim e sipër ”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet Gjykatës, për të caktuar një likuidues.

*Neni 18*  
*Likuiduesi*

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përvëçse kur akti i emërimit

parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtronhet mbikëqyrjes së ortakeve dhe administratorit.

Neni 19  
Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

3. Nëse në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë Gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 20  
Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetur, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”

Neni 21  
Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njérës ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqërie tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet

bashkim me pérthithje.

2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

Neni 22  
Ndarja

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose më shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 datë 14.04.2008..

3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.

4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë:

kalimin e shoqërisë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërite, si dhe për palët e treta; bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërite pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;

vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" pa kryerjen e likuidimit.

Neni 23  
Shndërrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionere.

Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 24  
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me ketë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Përsa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 25  
Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata shqiptare.

Neni 26  
Dispozita përfundimtare

Ky statut u redaktua në 4 kopje me vlera të njëjtë juridike në gjuhën shqipe, dhe pasi iu lexua ortakëve themeltar të shoqërisë, nënshkruhet me vullnetin e tyre të lirë nga ortakët themelues.

Autorizohet administratori i shoqërisë që të kryejë cdo procedurë të nevojshme lidhur me depozitimin e statutit në QKB dhe regjistrimin e shoqerisë .

**ORTAKËT E SHOQËRISË “BELED” sh.p.k**

*Enis Prushi*

**1. Enis Prushi**

*E.P.*

**2. Leandro Ceku**

*Leandro Ceku*

*Jurij*

**3. Biori Boka**

*Biori Boka*

*BB*